



Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 14 prill 2014

Lëndët nr. 120/09 & 121/09

R. P.

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 14 prill 2014, me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat janë paraqitur nga znj. R.P. më 4 prill 2009 dhe janë regjistruar më 30 prill 2009.
2. Më 19 nëntor 2009, Paneli i bashkoi lëndët nr. 120/09 dhe 121/09 në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së punës. Po të njëjtën ditë, për ankesat u njoftua Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)¹, lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesave.

¹Një listë me shkurtesa dhe akronime që përmban teksti mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

3. Më 2 shkurt 2010, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.
4. Më 18 gusht 2010, Paneli ia përcolli ankueses përgjigjen e UNMIK-ut dhe e ftoi atë të ofrojë komente, nëse e dëshironte këtë. Nuk u pranua asnjë përgjigje.
5. Më 15 nëntor 2010, Paneli mësoi për vdekjen e ankueses dhe pranoi nipin e saj z. R.P., si person me të drejtën për të vazhduar me ankesat. Për arsye praktike, Paneli do të vazhdojë ta konsiderojë znj. R.P. si ankuese, megjithëse ajo kompetencë tani duhet atribuuar z. R.P.
6. Më 26 nëntor 2010, Paneli i shpalli ankesat të pranueshme. Më 30 nëntor 2010, Paneli ia përcolli vendimin e vet mbi pranueshmërinë PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesave së bashku me dosjet hetimore.
7. Më 25 shkurt 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.
8. Më 29 prill 2013, Paneli i kërkoi UNMIK-ut të konfirmojë nëse hapja e dosjeve që kanë të bëjnë me lëndën mund të konsiderohet përfundimtare. Më 14 qershor 2013, UNMIK dha përgjigjen e vet.
9. Më 10 shtator 2013, UNMIK-u i ofroi Panelit një kopje të dosjes hetimore në lidhje me ankesat.

II. FAKTET

A. Historiku i përgjithshëm²

10. Ngjarjet në fjalë ndodhën në territorin e Kosovës pas krijimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut), në qershor të vitit 1999.
11. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ-ja u pajtua t'i tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ-ja dhe

²Referencat e nxjerra nga Paneli për të përcaktuar historikun e përgjithshëm përfshijnë: OSBE, “Siç është parë dhe treguar”, vëll. I (tetor 1998 – qershor 1999) dhe vëll. II (14 qershor – 31 tetor 1999); raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; Raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut (2000, 2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, “Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë” (2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, “Libër kujtimi për Kosovën” (<http://www.kosovomemorybook.org>); Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, Raport i Aktivitetit 2002-2004; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Behrami dhe Behrami kundër Francës dhe Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*, me numrat 71412/01 dhe 78166/01, vendimi i datës 2 maj 2007; Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, “Situata në Kosovë: Një vlerësim” (2010); të dhënat e publikuara nga Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, (në dispozicion në www.unhcr.org) dhe nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar (në dispozicion në <http://familylinks.icrc.org/kosovo/en>).

Republika e Serbisë nënkruan një “Marrëveshje Tekniko-Ushtarake” përmes së cilës u pajtuan mbi tërheqjen e RFJ-së nga Kosova dhe praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë, pas miratimit të rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

12. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislativë dhe ekzekutive. KFOR-i u ngarkua për krijimin e “një ambienti të sigurt, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt” dhe përkohësisht të sigurojë “rendin dhe sigurinë publike”, derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë apo shtylla kryesore të udhëhequra nga OKB-ja (administrata civile), Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (ndihma humanitare, e cila u hoq në qershorin e vitit 2000), OSBE-ja (ndërtimi institucional) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik). Secila shtyllë u vendos nën autoritetin e PSSP-së. Përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), UNMIK-ut i jepet mandati që t’i “promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut” në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
13. Vlerësimet lidhur me ndikimin e konfliktit në shpërnguljen e popullatës shqiptare të Kosovës sillen prej përafërsisht 800,000 deri 1.45 milion. Pas miratimit të Rezolutës 1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin larguar, apo ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit, u kthyen në Kosovë.
14. Në ndërkohë, pjesëtarët e komunitetit joshqiptar-kryesisht serbët, dhe jo vetëm ata, por edhe romët dhe myslimanët sllavë si dhe shqiptarët e Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, u bënë shënjestër e sulmeve shumë të përhapura të grupeve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet e tanishme lidhur me numrin e serbëve të Kosovës të zhvendosur sillen përafërsisht prej 200,000 deri 210,000. Ndërsa shumica e serbëve të Kosovës dhe joshqiptarët e tjerë të Kosovës u larguan në Serbi dhe në vendet fqinje, ata që mbetën prapa u bënë viktimat të vrasjeve sistematike, rrëmbimeve, mbajtjeve arbitrare, dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, rrahjeve dhe frikësimit.
15. Megjithëse shifrat mbesin kontestuese, vlerësohet që më shumë se 15,000 vdekje apo zhdukje ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij (1998-2000). Më shumë se 3,000 shqiptarë etnikë dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera minoritare u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Për më shumë se gjysmën e personave të zhdukur janë gjetur dhe identifikuar mbetjet e tyre mortore deri në fund të vitit 2010, ndërsa 1,766 gjenden ende si të zhdukur në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), sipas të dhënave të muajit tetor 2012.
16. Prej korrikut të vitit 1999, si pjesë e përpjekjeve për të rivendosur zbatimin e ligjit në Kosovë brenda kornizës së sundimit të ligjit, PSSP-ja u kërkoi vendeve anëtare të OKB-së që të mbështesin vendosjen brenda komponentit civil të UNMIK-ut, të policëve ndërkombëtarë prej 4,718 vetash. Policia e UNMIK-ut u ngarkua me këshillimin e KFOR-it mbi çështjet policore, derisa ata vetë të kenë numër të mjaftueshëm për të marrë krejt

- përgjegjësinië për zbatimin e ligjit dhe të punojnë drejt zhvillimit të Shërbimit Policor të Kosovës. Deri në shtator të vitit 1999, përafërsisht 1,100 policë ndërkombëtarë u vendosën në Kosovë në kuadër të UNMIK-ut.
17. Deri në dhjetor të vitit 2000, vendosja e Policisë së UNMIK-ut pothuajse përfundoi me 4,400 policë nga 53 vende të ndryshme dhe UNMIK-u kishte marrë primatin sa i përket përgjegjësisë për zbatimin e ligjit në të gjitha rajonet e Kosovës, përveç Mitrovicës. Sipas Raportit vjetor të Policisë së UNMIK-ut për vitin 2000, atyre u janë raportuar 351 rrëmbime, 675 vrasje dhe 115 dhunime për periudhën qershor 1999 - dhjetor 2000.
 18. Për shkak të kolapsit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, UNMIK-u në qershor të vitit 1999 themeloi një Sistem emergjent të drejtësisë. Ai përbëhej nga një numër i kufizuar gjyqtarësh dhe prokurorësh vendorë dhe ishte operacional derisa sistemi i rregullt i drejtësisë u bë operacional në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës dhe më vonë në gjithë Kosovën, për të forcuar sistemin lokal të drejtësisë dhe për të garantuar paanësinë. Prej tetorit të vitit 2002, sistemi lokal i drejtësisë përbëhej prej 341 gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë dhe 24 ndërkombëtarë. Në janar të vitit 2003, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, duke i raportuar Këshillit të Sigurimit për zbatimin e Rezolutës 1244 (1999), sistemin e policisë dhe drejtësisë në Kosovë në atë kohë e definoi si sistem që “funksionon mirë” dhe “i qëndrueshëm”.
 19. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit që UNMIK-u tashmë e konsideronte çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht të madh për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në muajin nëntor të vitit 1999, u krijua Njësitë për Personat e Zhdukur (NJPZH) brenda Policisë së UNMIK-ut, me mandat të hetojë vendndodhjen e mundshme të personave të zhdukur dhe/apo varrezave. NJPZH-ja, së bashku me Njësitin Qendror për Hetim të Krimit (NJQHK) të Policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë Njësitë për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL), ishin përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Në maj të vitit 2000, u krijua Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave (KGJIV), i udhëhequr nga UNMIK-u, për të gjetur, identifikuar dhe dorëzuar mbetjet mortore. Prej qershorit të vitit 2002, Zyra e sapoformuar për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut (DDU), u bë autoriteti i vetëm i mandatuar për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, t’i identifikojë mbetjet e tyre mortore dhe t’ua kthejë ato familjes së të zhdukurit. Duke filluar nga viti 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet UNMIK-ut dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur me seli në Sarajevë (KNPZH), i plotësuar nga një marrëveshje tjetër në vitin 2003, identifikimi i mbetjeve mortore u krye nga KNPZH-ja përmes testit të ADN-së.
 20. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.
 21. Po të njëjtën ditë, UNMIK-u dhe EULEX-i nënshkruan një MM mbi modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që dalin nga transferimi prej UNMIK-ut tek EULEX-i, i

lëndëve dhe dosjeve përkatëse të cilat përfshinin hetimet, ndjekjet penale në vijim dhe aktivitetet e tjera të ndërmarra nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Menjëherë pas kësaj, marrëveshje të ngjashme u nënshkruan në lidhje me dosjet e mbajtura nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe Policia e UNMIK-ut. Të gjitha marrëveshjet obliguan EULEX-in të sigurojë qasje nga UNMIK-u në dokumentet që ndërlidhen me veprimet që autoritetet e UNMIK-ut i kanë ndërmarrë më parë. Në periudhën 9 dhjetor 2008 deri më 30 mars 2009, të gjitha dosjet me lëndë penale të mbajtura nga DD i UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut, iu dorëzuan EULEX-it.

B. Rrethanat që ndërlidhen me rrëmbimin dhe vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P.

22. Ankuesja është nëna e z. R.P. (lënda nr. 120/09) dhe gruaja e z. M.P. (lënda nr. 121/09). Në parashtresën e saj para Panelit, ajo deklaroi se në mes datës 15 dhe 17 korrik të vitit 1999, burri dhe djali i saj ishin duke udhëtuar nga Mali i Zi, në një kamion Mercedes, për të transportuar mallra për një ndërmarrës privat të treguar me emër. Automjeti i tyre me sa duket u prish gjatë udhëtimit, në afërsi të Komunës së Klinës. Ajo deklaroi se, që nga ajo kohë, ata ishin të pagjetur derisa mbetjet e tyre mortore u identifikuan dhe iu dorëzuan familjes në vitin 2005.
23. Emrat e z. R.P. dhe z. M.P. gjenden edhe në listat e personave të zhdukur që KNKK ia dërgoi Policisë së UNMIK-ut më 12 tetor 2001 dhe 11 shkurt 2002, për të cilët ishin mbledhur të dhëna ante-mortem. Emrat e tyre janë gjithashtu të përfshirë në bazat e të dhënave të përpiluara nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe KNPZH; në shënimet në lidhje me z. R.P. dhe z. M.P. në bazën e të dhënave ‘online’ të KNPZH-së, në pjesët relevante thuhet “Janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë” dhe “KNPZH i ka ofruar informata për personin (at) e zhdukur... institucionit të autorizuar”.
24. Ankuesja i dorëzoi Panelit dokumentet (certifikatat e vdekjes, certifikatat e identifikimit dhe konfirmimit të identitetit) nga ish-ZPZHML-ja dhe KNPZH-ja sipas të cilave mbetjet mortore të z. R.P. dhe z. M.P. ishin gjetur më 1 qershor 2005 në Klinë. Ato ishin identifikuar përmes testeve të ADN-së nga KNPZH-ja në nëntor të vitit 2005 dhe i ishin dorëzuar familjes në dhjetor të vitit 2005. Në certifikatën e vdekjes për z. R.P., e datës 22 nëntor 2005, thuhet se shkaktari i vdekjes nuk ishte konstatuar; ndërsa në certifikatën e vdekjes për z. M.P., e datës 24 nëntor 2005, thuhet se vdekja e tij ishte shkaktuar nga e shtëna me armë në gjoks.

C. Hetimi

25. Në rastin aktual, Paneli pranoi nga UNMIK-u dokumente hetimore që më parë i kishin mbajtur ZPZHML e UNMIK-ut dhe NJKL e Policisë së UNMIK-ut. Paneli thekson se UNMIK-u ka konfirmuar se janë ofruar të gjitha dokumentet në dispozicion.
26. Për sa i përket publikimit të informatave që përmbajnë dosjet, Paneli rikujton që UNMIK-u i ka vënë në dispozicion dosjet për hetim për t’u shqyrtuar nga Paneli nën një zotim për konfidencialitet. Në lidhje me këtë, Paneli duhet të qartësojë që megjithëse vlerësimi i dosjes aktuale rrjedh nga një shqyrtim i plotë i dokumentacionit në dispozicion, vetëm informata të limituara që ekzistojnë aty janë publikuar. Prandaj, një përmbledhje e hapave të ndërmarrë nga autoritetet e hetuesisë është dhënë në paragrafët në vijim.

Informatat e Njësisë për Inteligjencë e Policisë së UNMIK-ut

27. Dosja hetimore përmban një memorandum, të datës 20 prill 2000, me një kërkesë nga shefi i Qendrës për informim i Policisë së UNMIK-ut për komandantin rajonal të Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë, në të cilin në rubrikën “Lënda” thuhet “Kampet e përqendrimit”. Në memorandum kërkohet që Policia e UNMIK-ut në Mitrovicë të çojë më tutje një “kërkesë diplomatike që për ndjeshmërinë e situatës ne do të vlerësonim një trajtim të veçantë nga oficerët tuaj të caktuar”. Në të thuhet më tutje se nuk ka asnjë informatë rreth ekzistencës së një kampi të përqendrimit “prapa ndërtesës së Sigurimit social” në Mitrovicë “ku mbahen disa qytetarë kundër dëshirës së tyre”.
28. Një memorandum si përgjigje ndaj kërkesës së mësipërme gjithashtu është i përfshirë në dosje, i datës 27 prill 2000, nga SHP rajonal për Inteligjencë i Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë për shefin e Qendrës për informim, që dërgon një raport të titulluar “Burgjet e UÇK-së në territorin e KA të K. dhe M. dhe në Republikën e Shqipërisë”. Raporti përmban një listë të plotë të 111 qendrave të fshehta të paraburgimit të UÇK-së duke treguar vendin e tyre të saktë në gjithë Kosovën dhe në pjesën veriore të Shqipërisë. Për disa qendra paraburgimi, në raport tregohen gjithashtu pjesëtarët e UÇK-së me sa duket përgjegjës apo që drejtonin qendrat dhe gjithashtu emrat e atyre të paraburgosurve atje. Në titullin “Skënderaj” të raportit thuhet, së bashku me informatat e tjera, “2 burgje në Skënderaj. Në ato burgje janë [z. R.P.] (1961), etj.”
29. Nuk ka asnjë dokument tjetër në dosje lidhur me këtë çështje.

Hetimi i NJPZH-së

30. Nga dosja hetimore duket se dosjet për persona të zhdukur lidhur me z. R.P. dhe z. M.P. ishin hapur nga NJPZH e UNMIK-ut në një kohë në vitin 2001 (të dyja me lëndën nr. 2001-011304).
31. Dosja hetimore përmban një memorandum, të datës 16 prill 2004, që është dërguar nga Zyra për persona të zhdukur e UNMIK-ut në Beograd për shefin e ZPZHML-së dhe NJPZH-së së UNMIK-ut, në rubrikën e të cilit “Lënda” thuhet “PZH [R.P. dhe M.P.] (NJPZH 2001-001034). Në tekstin kryesor të memorandumit thuhet se “deklaratat” lidhur me personat e lartpërmendur të zhdukur ishin përcjell. E bashkangjitur me memorandumin është kopja e deklaratës së dëshmitarit marrë nga ankuesja znj. R.P., në Zyrën e UNMIK-ut në Beograd më 15 prill 2004.
32. Në deklaratën e saj, ankuesja deklaron se burri dhe djali i saj ishin zhdukur që nga 15 korriku i vitit 1999. Djali i saj, z. R.P., ishte i punësuar si shofer kamioni në një kompani transportuese në pronësi të personit të treguar me emër, z. J.R. Kompania ishte me seli në një adresë të specifikuar në Nish, Serbi. Më 12 korrik 1999, z. J.R., i kishte kërkuar z. R.P. të voziste një kamion nga Cetinje, në Mal të Zi deri në Kosovë për të dërguar mallra për një konsumator shqiptar të Kosovës të treguar me emër z. N. (është ofruar vetëm emri). Ky i fundit ishte pronar i një kompanie të treguar me emër, me seli në Prishtinë, i cili i kishte shfrytëzuar shpesh shërbimet e kompanisë së tyre të transportit dhe i cili i njihte z. R.P. dhe

- z. M.P. shumë mirë. Më 13 korrik 1999, z. R.P. dhe babai i tij u larguan nga Mali i Zi me një kamion Mercedes (targat e regjistrimit janë ofruar). Më 14 korrik 1999, ankuesja mori një thirrje telefonike nga djali i saj në Mal të Zi, i cili e informoi atë se ata e kishin ngarkuar kamionin me mallra dhe ishin në rrugë për në Nish, duke planifikuar t'i dorëzonin mallrat në Prishtinë në ditën vijuese. Kjo ishte hera e fundit që ajo dëgjoi për djalin e saj. Më 17 korrik 1999, ajo pranoi një thirrje telefonike nga pronari i kompanisë transportuese, i cili i tregoi asaj se ai ishte informuar nga z. N. se burri dhe djali i saj ishin zhdukur në Kosovë. Ajo mori numrin e telefonit të z. N. Ajo e thirri atë dhe ai i tregoi asaj se, më 14 korrik 1999, ai ishte pajtuar me z. R.P. që të takoheshin në Rozhajë, Mal të Zi, dhe nga atje, të shkojnë së bashku në Prishtinë. Sipas rrëfimit të z. N., z. R.P. ishte në kamion me vëllanë e N.-së, ndërsa ai dhe z. M.P. po i ndiqnin pas me furgonin e tij. Afër Klinës frenat e kamionit ndaluan së funksionuari, z. R.P. ia arriti ta ndalë atë në fund; megjithatë, në këtë proces vëllai i z. N. kërceu nga kamioni dhe lëndoi supin e tij. Ankuesja deklaroi se z. N. vendosi ta çojë vëllanë e tij në spital në Prishtinë dhe, pavarësisht nga kërkesa e tyre për të shkuar së bashku, ai i la z. R.P. dhe z. M.P. prapa, duke thënë se ata ishin të sigurt meqë kishte një postbllok të KFOR-it në afërsi. Pak orë më vonë z. N. u kthye por ai nuk mundi të gjente ndonjë gjurmë për z. R.P. dhe z. M.P., dhe as për kamionin. Ankuesja deklaroi se disa javë më vonë z. N. i dërgoi asaj para (1000 dinarë). Ajo gjithashtu deklaroi se në maj të vitit 2002, ajo pranoi një thirrje telefonike nga një grua e panjohur, e cila i tregoi asaj se e kishte marrë numrin nga "shqiptari", i cili i njihte djalin dhe burrin e saj dhe se ata ishin ende të gjallë. Në gusht të vitit 2003, ajo e vizitoi shtëpinë e z. N. në Prishtinë, por ajo nuk ishte lejuar të hyjë brenda. Ajo deklaroi se besonte që z. N. ishte "disi i përfshirë në rrëmbimin e djalit dhe burrit të saj", megjithëse ajo nuk kishte ndonjë dëshmi për ta dëshmuar këtë. Gjithashtu, ajo deklaroi se ajo nuk kishte ofruar mostrat e gjakut deri më tani me qëllim të testit të ADN-së.
33. Në dosje është gjithashtu një material i shtypur i një raporti të NJPZH-së i marrë më 22 korrik 2004, lidhur me rastin e z. M.P., i shënuar si lënda për rastin e NJPZH-së nr. 2001-001034. Në raport tregohet se dosja ishte hapur më 11 prill 2001 dhe se z. M.P. ishte zhdukur më 16 korrik 1999 së bashku me djalin e tij afër Klinës.
34. Paneli gjithashtu e ka në posedim përkthimin në anglisht të një letre dërguar DD-së së UNMIK-ut nga "Asociacioni i Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur në Kosovë dhe Metohi" (Asociacioni), i datës 1 dhjetor 2004. Me këtë letër, Asociacioni ia përcolli DD-së njëmbëdhjetë kallëzime penale, duke përfshirë një nga ankuesja lidhur me zhdukjen e z. R.P. dhe z. M.P. Sipas fusnotës në dokument, kallëzimi penal (jo i bashkëngjitur) ishte përkthyer nga një përkthyes i DD-së më 21 shkurt 2005.
35. Dosja hetimore gjithashtu përmban kopjet e dokumenteve të ZPZHML-së dhe KNPZH-së të lëshuara pas zbulimit të mbetjeve mortore më vonë të identifikuara si ato të z. R.P. dhe z. M.P. Megjithatë, të përfshira në dosje janë vetëm dokumentet (raporti i autopsisë, certifikata e vdekjes, krahasimi i të dhënave ante-mortem dhe post-mortem, raporti i ADN-së) në lidhje me z. M.P. i përmendur në këtë kohë, si lënda e NJPZH-së nr. 2001-00134. Sipas këtyre dokumenteve, më 1 qershor 2005, mbetjet mortore të z. M.P. ishin gjetur në Klinë. Më 20 qershor 2005, ZPZHML e kreu autopsinë në mbetjet mortore, e cila përcaktoi se vdekja ishte shkaktuar nga plaga me armë zjarri në gjoks. Një raport autopsie ishte lëshuar më 14 tetor 2005. Më 24 tetor 2005, KNPZH vërtetoi përmes testit të ADN-së që mbetjet mortore ishin të z. M.P. Më 16 nëntor 2005, u bë një krahasim nga ZPZHML në mes të informatave ante-mortem dhe post-mortem lidhur me mbetjet mortore që besohej të

jenë ato të z. M.P., me rezultate pozitive. Më 24 nëntor 2005, ZPZHML lëshoi një certifikatë për konfirmim të identitetit në lidhje me këtë. E përfshirë në dosje është gjithashtu një informatë ante-mortem, pa datë, për z. M.P.

36. Megjithëse nuk është përfshirë në dosjen hetimore të dorëzuar nga UNMIK-u, Panelit i është ofruar nga ankuesja një kopje e certifikatës së vdekjes, certifikatës së identifikimit dhe certifikatës së identitetit bazuar në testet e ADN-së lidhur me djalin e saj, z. R.P., të cilat ishin lëshuar në kornizën e njëjtë kohore (shih § 24 më lart).
37. Më 8 dhjetor 2005, mbetjet mortore të z. R.P. dhe z. M.P. iu dorëzuan familjeve të tyre.

Hetimi i NJKL-së

38. Dosja hetimore përmban një material të shtypur nga baza e të dhënave e NJKL-së, i marrë më 10 shtator 2005, i cili i referohet numrit të hetimit 0384/INV/04 dhe dosjeve për rastin të NJPZH-së për z. R.P. dhe M.P., këtu e paraqitur si lënda për rastin e NJPZH-së nr. 2001-001034. Në rubrikat “Lloji i hetimit” dhe “Data”, të raportit thuhet, “Ante mortem” përkatësisht “17 prill 04”. Në rubrikën “Përmbledhje e kërkesës” thuhet: “ka mungesë të informatave. Ricaktuar më 6/11/04 Kristianit. Ricaktuar më 5/04/05 Igorit”. Në pjesën “Shënime për hetimin”, të raportit thuhet “Referoju raportit të hetuesit. Deri më tani nuk ka asnjë informatë që çon te gjetja e PZH-së”. Në rubrikat “Rezultatet” dhe “Data e rezultatit”, në raport thuhet, “Në zhvillim e sipër”, përkatësisht “7/05/2005”.
39. Dosja gjithashtu përmban një raport të hetimit ante-mortem të NJKL-së, që i referohet hetimit nr. 0384/INV/04 dhe rasteve të z. R.P. dhe z. M.P., këtu e paraqitur si lënda për rastin e NJPZH-së nr. 2001-001034. Në raport, i filluar më 17 qershor 2005 dhe i përfunduar më 5 korrik 2005, përmenden me emra dy dëshmitarë për rastin, pikërisht znj. R.P., nëna e z. R.P. dhe gruaja e z. M.P., dhe z. N.B. (personi i njëjtë si z. N. nga § 32), i paraqitur si “dëshmitar okular”. Detajet e tij të plota për kontakt, duke përfshirë adresën dhe numrin e telefonit janë përfshirë në raport. Në rubrikën “Statusi” në raport thuhet “Joaktiv”. Në rubrikat “Lloji i informatave”, dhe “Historiku i informatave”, të raportit përmbledhet rrëfimi i fakteve siç i janë ofruar nga znj. R.P. Zyrës për persona të zhdukur të UNMIK-ut në Beograd (shih § 32 më lart). Në rubrikën “Hetimi i mëtejme” në raport thuhet se hetuesit kishin provuar ta kontaktojnë z. J.R., pronarin e kompanisë transportuese për të cilën ishte duke punuar z. R.P., megjithatë, “numri ishte i gabuar”. Prandaj, hetuesit kishin shkuar në “Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Dhomën e Tregtisë” për të kërkuar të dhënat lidhur me një kompani të caktuar e treguar nga znj. R.P. dhe kështu kishin marrë detajet për kontakt të z. N.B. Në rubrikën e njëjtë “Hetimi i mëtejme” në raport më tutje thuhet se, duke i shfrytëzuar burimet e internetit, hetuesit kishin gjetur informacione të Qendrës për të Drejtën Humanitare lidhur me zhdukjen e z. R.P. dhe z. M.P. Sipas kësaj dëshmie, “shqiptari” për të cilin z. R.P. dhe z. M.P. ishin duke transportuar mallrat nga Mali i Zi i kishte thënë znj. R.P. se, më 16 qershor 1999, z. R.P. dhe vëllai i tij (vëllai i “shqiptarit”) ishin duke vozitur kamionin ‘Mercedes’ ndërsa ai dhe z. M.P. ishin duke i përcjell me automjetin tjetër. Afër urës në Klinë, frenat e kamionit “nuk funksionuan” dhe “ndërsa djali i tij po përpiquej ta ndalte automjetin, vëllai i shqiptarit ra nga kamioni dhe e lëndoi pak supin e tij”. Meqë “shqiptari” vendosi ta çojë vëllanë e tij në spital, ata e parkuan kamionin pranë urës dhe i kërkuan atij mos t’i lërë vetëm në rrugë. “Shqiptari” u përgjigj se nuk ka nevojë për t’u brengosur pasi ishte një postbllok i KFOR-it në afërsi. Në raport përmendet më tutje burimi tjetër i internetit, që thuhet se paraqet informatat e dhëna nga gruaja e z.

R.P. Nuk janë shtuar detaje tjera në këtë pjesë të raportit, përveç emrit të z. N.B., “shqiptarit” për të cilin z. R.P. dhe z. M.P. ishin duke transportuar mallrat dhe numri i tij i telefonit. Në rubrikën “Dëshmitari i intervistuar” në raport thuhet se dëshmitari i parë i intervistuar ishte znj. R.P. dhe se deklarata e saj i ishte bashkangjitur raportit. E bashkangjitur me raportin është një kopje e deklaratës që znj. R.P. ia kishte dhënë Zyrës për persona të zhdukur të UNMIK-ut në Beograd në prill të vitit 2004 (shih §§ 31-32 më lart). Dëshmitari i dytë i intervistuar ishte z. N.B.

40. Në rubrikën “Deklarata e dëshmitarit”, në raportin e njëjtë të hetimit ante-mortem, paraqitet deklarata e z. N.B. e cila, megjithatë nuk ka asnjë nënshkrim. Thuhet se në deklaratën e tij për NJKL-në, z. N.B. deklaroi se ai deshi të organizonte transportimin e thithëseve elektrike nga një fabrikë në Nish, Serbi, për në Prishtinë. Ai e kishte thirrur z. B. (nofka për z. J.R. nga §§ 32 dhe 39 më lart), pronarin e një kompanie transportuese në Nish, dhe e pyeti atë nëse ai ishte i gatshëm të aranzhojë transportin, pavarësisht nga situata e sigurisë menjëherë pas luftës (nuk është ofruar asnjë datë në krejt deklaratën). Pasi z. B. ishte pajtuar të aranzhojë dërgimin e mallrave, z. N.B. priti kamionin në hyrjen “Novi Pazar – Zubin Potok” në Mitrovicë, me qëllim që ta përcjellë atë në Kosovë. Kur kamioni arriti, z. R.P. ishte duke vozitur vetë. Ata shkuan në depon e z. N.B. në Prishtinë për t’i shkarkuar mallrat dhe pastaj z. N.B. e pyeti z. R.P., nëse ai mund të transportonte ngarkesën tjetër të “pajisjeve” nga Cetinja në Mal të Zi deri në Prishtinë. Pasi për këtë ishte pajtuar z. B., ata bënë marrëveshje të takohen në vendin e përmendur me emër në Serbi, ashtu që z. B. të mund të sillte ca karburante për kamionin atje dhe gjithashtu për babanë e z. R.P., i cili deshi ta ndihmojë djalin e tij në udhëtim. Z. R.P. dhe z. M.P. pastaj shkuan në Mal të Zi dhe u kthyen në Kosovë, ku ata takuan z. N.B. “në postbllokun nën kontroll të KFOR-it italian”. Ai i kërkoi z. R.P. dhe z. M.P. të jenë në automjet me të dhe ta lënë vëllanë e tij, z. Ne.B., ta vozisë kamionin pasi ajo do të ishte më e sigurt për ta dhe ngarkesën; megjithatë z. R.P. me sa duket refuzoi për shkak se kishte problem me frenat e kamionit. Pas kësaj z. M.P. shkoi në automjetin e tij ndërsa vëllai i tij shkoi në kamion me z. R.P. Ai deklaroi se pas 5 km kamioni filloi të shkonte shumë shpejt. Në fillim kamioni ishte prapa por pas ngritjes së shpejtësisë i tejkaloi ata derisa z. R.P. ia arriti ta ndalë atë në përpjetëz. Në atë moment z. R.P. zbriti nga kamioni, erdhi tek automjeti i tij dhe i tha atij se vëllai i tij z. Ne.B., ishte frikësuar gjatë vozitjes dhe kishte kërcyer nga kamioni. Ai u kthye për të shikuar për vëllanë e tij, por ishte shumë errët. Ai e ndali një automjet privat që po kalonte rrugës dhe i kërkoi shoferit t’i ndihmojë për ta gjetur vëllanë e tij. Pas pak, automjeti i njëjtë u kthye me z. Ne.B. Ky i fundit ishte pa vetëdije dhe kokën e kishte në gjak, kështu që z. N.B. vendosi ta dërgojë atë në spital. Ai i kërkoi z. R.P. dhe z. M.P. të ktheheshin në postbllokun italian, pasi ata po niseshin për në spital. Nën përcjelljen e KFOR-it, ai së pari e dërgoi vëllanë e tij në spital në fshatin Banjë, dhe nga atje tek ai në Pejë, pasi gjendja e vëllait të tij ishte diagnostikuar si serioze nga mjekët. Rrugës për në Pejë, ai kaloi pranë postbllokut italian por nuk mundi të shihte kamionin atje. Pasi e la vëllanë e tij në spital dhe kthimit prapa në Prishtinë për t’i informuar anëtarët e familjes së tij, ai i pa dritat e përparme të kamionit pranë urës së Klinës. Ai foli me z. R.P. dhe z. M.P. dhe u kërkoi atyre të kthehen, por ata këmbëngulën se ata dëshironin të shkojnë në Prishtinë. Ai tha se, ai së pari do të shkonte në Prishtinë te familja e tij dhe pastaj do të kthehej në spital dhe se, ai “do të takohej me ta gjatë kthimit”. Z. N.B. u kthye në shtëpi dhe e ndërroi automjetin e tij, pastaj ai u kthye duke shfrytëzuar rrugën e njëjtë; megjithatë nuk kishte asnjë gjurmë të kamionit. Ai e mori vëllanë e tij nga spitali dhe së bashku shkuan në postbllokun italian. Ai nuk e pa kamionin atje dhe mendoi se z. R.P. dhe z. M.P. kishin shkuar në Mal të Zi. Ai e thirri pronarin e kompanisë transportuese, z. B., i cili tha se ai nuk kishte pranuar ndonjë thirrje apo lajm nga

- z. R.P. dhe z. M.P. Një muaj më vonë, znj. R. P. e thirri atë dhe i tha atij se z. B. nuk i kishte dhënë asnjë para dhe se ajo kishte nevojë për ndihmë, pasi nipi i saj ishte i sëmurë. Për këtë arsye, ai i kishte dërguar asaj para “disa herë”. Më vonë znj.R.P. e thirri atë për t’i thënë se “ajo kishte shkuar në gjykatë” dhe ajo ishte hera e fundit që ata kishin folur.
41. Në rubrikën “Përfundim” të raportit të hetimit ante-mortem thuhet: “nuk ka informata që çojnë kah gjetja e mundshme e PZH-së. Ky rast duhet të mbetet në zhvillim e sipër joaktiv në kuadër të NJKL-së”. Në të thuhet se, më 10 gusht 2005, raporti ishte nënshkruar për aprovim nga një udhëheqës i ekipit të NJKL-së.
42. Duket se rasti ishte rishqyrtuar nga NJHKL-ja në korrik të vitit 2007. Dosja hetimore përmban materialin e shtypur nga baza e të dhënave e NJHKL-së, i marrë më 19 tetor 2007, që përmban një raport për lëndën e rastit të z. R.P. dhe z. M.P., të regjistruar si lënda për rastin nr. 2005-00107. Në rubrikën “Lloji i krimit” të raportit thuhet “Person i zhdukur (Rrëmbim i dyshuar). Në rubrikat “Data” dhe “Statusi”, në raport thuhet, “8/16/2005” përkatësisht “Joaktiv”. Në rubrikën “Përmbledhje”, në raport thuhet se personat e zhdukur ishin larguar që të shkojnë nga Peja për t’ia transportuar disa mallra z.N. (vetëm emri ofrohet në këtë raport) një “shqiptar nga Prishtina”, i cili gjithashtu iu bashkua atyre në kamion. Thuhet se kamioni ishte prishur pranë një ure afër Klinës dhe z. N. “gjoja shkoi në Prishtinë me qëllim të gjetjes së një automekaniku për ta riparuar kamionin”. Ditën vijuese z. N. e kishte informuar familjen e tyre se ai nuk i kishte gjetur ata gjatë kthimit. Në raport thuhet më tutje se, më 8 dhjetor 2005, mbetjet mortore të z. R.P. dhe z. M.P. u ishin dorëzuar familjes së tyre.
43. Dosja përmban një raport të analizës së rastit të NJKL-së të përpiluar më 21 tetor 2007 dhe rishqyrtuar për miratim më 25 tetor 2007. Përveç informatave që përmban raporti i lartpërmendur (§ 41), në raport, në rubrikën “Rekomandimi/mendimi i hetuesit” thuhet “pasi dosjes i mungon deklarata e [N-së.] unë konsideroj se rasti nuk duhet mbyllur, pa së paku këtë pjesë të dëshmisë. Kështu që unë sugjeroj që të kryhet hetimi i mëtejshëm nga SHPK-ja apo Policia ndërkombëtare”. Raporti gjithashtu përmban një shënim të shkruar me dorë, ku thuhet se rasti ishte shqyrtuar më vonë më 21 nëntor 2007 dhe se ishte sugjeruar që të ndryshohet klasifikimi i rastit në “D3”, meqë nuk kishte “asnjë dëshmi të hollësishme” se rasti kishte “ndërlidhje me një rast për krime lufte”.
44. Nga dosja e dorëzuar nga UNMIK-u shihet se rasti ishte rishqyrtuar më tutje nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK), në korrik të vitit 2009. E bashkëngjitur në dosje është një kërkesë për të kryer hetim kundër autorëve të panjohur, e datës 27 korrik 2009, e lëshuar nga prokurori ndërkombëtar i ZPSK-së në lidhje me rastin e z. R.P. dhe z. M.P. (këtu e përmendur si “Numri i Policisë së UNMIK-ut 2000-00107). Ky dokument përmban përmbledhjen e njëjtë të fakteve si në raportin e analizës së rastit të NJHKL-së së UNMIK-ut të tetorit të vitit 2007 (shih § 41 më lart); përveç kësaj, në të thuhet se “mbetjet e [M.P.] ishin gjetur dhe dorëzuar familjes”. Me këtë kërkesë, prokurori ndërkombëtar i kërkon shefit të Policisë së EULEX-it për Krime Lufte “të kryejë veprimet vijuese hetimore: të provojë ta gjejë PZH-në përmes I.O.; t’i intervistojë të afërmit e PZH-së, dëshmitarin dhe palën raportuese” dhe të paraqesë gjetjet në një raport.
45. Dosja gjithashtu përmban dokumentin tjetër të ZPSK të EULEX-it, i datës 28 korrik 2009, që vlerëson rastin e z. R.P. dhe z. M.P., gjithashtu këtu i përmendur me numër të Policisë së UNMIK-ut 2002-00067. Në rubrikën “Data e raportit fillestar” në dokument thuhet “18-08-

2002” dhe nën “Rrethanat faktike” thuhet se viktimat u zhdukën nga Klina dhe se “ata kishin shkuar në spital dhe kurrë më nuk ishin parë”. Në dokument thuhet më tutje: “Ky rast është pikërisht i njëjti si 2005-00107: sipas asaj dosje mbetet ish gjetur dhe kthyer familjes”. Në rubrikën “Autopsia” në dokument thuhet “Jo”, dhe në “Vërejtje”: “Ky krim nuk është një krim lufte për shkak të datës së ngjarjes. Dosja e ka në listë një shqiptar, është vetëm emri dhe një numër i vjetër i telefonit i përmendur në dosje ... Deklaratat e anëtarëve të familjes mungojnë në dosje”. Në rubrikën “Vendimi” në dokument thuhet “Kopje e përkohshme përmbyllëse (në pritje të dosjes origjinale). Rasti i përfshirë në dosjen 2005-00107).

46. Dokumenti i fundit i përfshirë në dosje është një kopje e vendimit të prokurorit ndërkombëtar të ZPSK të EULEX-it, e datës 19 gusht 2009, për të pezulluar kallëzimin penal lidhur me vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P., këtu i përmendur me numër të Policisë së UNMIK-ut 2006-00034. Në vendim thuhet se “dosja e rastit nuk përmban asnjë element që mund të çojë te identifikimi i një të dyshuari të mundshëm” dhe se, për më tepër, “faktet kishin ndodhur jashtë kornizës kohore të krimeve të luftës dhe kjo dosje është e përfshirë në lëndën 2005-00107”.
47. Nuk është e qartë nga dosja hetimore nëse ish-lënda e NJHKL-së së UNMIK-ut nr. 2005-00107 është akoma në zhvillim e sipër në kuadër të ZPSK-së.

III. ANKESAT

48. Ankuesja ankohet rreth dështimit të pretenduar të UNMIK-ut që të hetojë si duhet zhdukjen dhe vrasjen e djalit dhe burrit të saj. Në lidhje me këtë, Paneli mendon që ankuesja mbështetet në shkeljen e obligimit procedural të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).
49. Ankuesja, po ashtu, ankohet për dhimbjet dhe vuajtjet mentale të supozuara që i janë shkaktuar asaj nga kjo situatë. Në lidhje me këtë, Paneli mendon që ankuesja bazohet në nenin 3 të KEDNJ-së.

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së

1. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

50. Në përcaktimin e asaj nëse konsideron që ka pasur një shkelje të nenit 2 (obligimi procedural) të KEDNJ-së, Paneli është i vetëdijshëm për praktikën ekzistuese gjyqësore, veçanërisht atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm që ankesat para tij dallojnë në disa mënyra domethënëse nga ato të paraqitura para asaj gjykate. E para, i padituri nuk është një shtet, por një administratë e përkohshme ndërkombëtare në një territor me mandat që t'i ushtrojë përkohësisht përgjegjësitë në Kosovë. Asnjë përgjegjësi nuk i bie UNMIK-ut sa u përket obligimeve esenciale sipas nenit 2 të KEDNJ-së. E dyta, si në një numër të kufizuar të lëndëve para Gjykatës Evropiane, ata që dyshohen të jenë përgjegjës për vrasjet dhe/apo rrëmbimet e

pretenduara, janë në të gjitha rastet para Panelit me palë joshtetërore, kryesisht që kanë të bëjnë me konfliktin, por jo vetëm me të. Këta janë faktorët për t'u marrë parasysh nga Paneli, meqë vlerëson obligimet pozitive procedurale të një organizate ndërqeveritare në lidhje me aktet e kryera nga palët e treta, në një territor mbi të cilin e ka kontrollin e përkohshëm legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

51. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.
52. Paneli thekson që me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligimet sipas këtyre instrumenteve për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat me të, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.
53. Paneli, po ashtu, thekson që neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/12, i 23 marsit 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli “shqyrton ankesat nga çdo person apo grup individësh që pohojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave (të tyre) të njeriut nga UNMIK-u”. Pra vetëm aktet apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut bien brenda juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në lidhje me këtë, duhet përmendur, siç është theksuar më lart, që prej 9 dhjetorit 2008 UNMIK-u nuk ushtron më autoritetin ekzekutiv mbi gjyqësinë e Kosovës dhe aparatit për zbatimin e ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk bart asnjë përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet se janë kryer nga ato autoritete. Sa i përket ankuesve që ankohen rreth akteve që kanë ndodhur pas asaj date, ato janë jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.
54. Po ashtu, Paneli thekson që, sa i përket juridiksionit të vet *ratione materiae*, siç vijon nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Kjo nënkupton që mundet vetëm t'i shqyrtojë aktet apo lëshimet për të cilat është bërë ankesë rreth pajtueshmërisë së tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura më lart (shih § 52). Në rastin e veçantë të vrasjeve apo zhdukjeve në rrethana kërcënimi të jetës, nuk është roli i Panelit t'i zëvendësojë autoritetet kompetente për hetimin e rastit. Detyra e tij është e kufizuar në shqyrtimin e efektivitetit të hetimit penal për vrasjet dhe zhdukjet e tilla, në dritën e obligimeve procedurale që rrjedhin nga neni 2 i KEDNJ-së.
55. Paneli thekson më tutje se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që Paneli ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut “që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut”. Pra, ngjarjet që kanë ndodhur para 23 prillit 2005, përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Megjithatë, në rastin kur ngjarjet e tilla kanë shkaktuar një situatë të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion t'i shqyrtojë ankesat që ndërlidhen me atë situatë (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Dhoma e Lartë [DHL],

Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë, nr. 16064/90 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 18 shtator 2009, §§ 147-149; GJEDNJ, *Qiproja kundër Turqisë* [DHL], numër 25781/94, vendimi i gjykatës, 10 maj 2011, § 136, KEDNJ 2001-IV).

2. Parashtrësit e palëve

56. Ankuesja në esencë pretendon për shkelje lidhur me mungesën e një hetimi adekuat penal për zhdukjen dhe vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P. Ankuesja gjithashtu deklaron që ajo nuk ishte informuar nëse ishte zhvilluar një hetim dhe çfarë ishte rezultati.
57. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesave, PSSP-ja pranon përgjegjësinë e UNMIK-ut në kryerjen e detyrave policore në territorin e Kosovës sipas Rezolutës së KSKB 1244(1999). PSSP-ja deklaron se kjo përgjegjësi në kryerjen e detyrave policore nënkupton që “UNMIK-u e kishte mandatin të mbrojë njerëzit në Kosovë nga aktivitetet kriminale dhe kryejë hetim efektiv për krimet”.
58. Megjithatë, sipas PSSP-së, kur shqyrtohet ankesa, duhet marrë parasysh se z. R.P. dhe z. M.P. u zhdukën menjëherë pas bombardimit të NATO-s dhe gjatë muajve të parë të vendosjes së UNMIK-ut, kur shkalla e krimit në Kosovë ishte më e larta. PSSP-ja i referohet raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi situatën në Kosovë të 12 korrikut të vitit 1999 duke deklaruar se, deri në gusht të vitit 1999, një numër i madh i serbëve të Kosovës ishin larguar për në Serbi, të shtyrë nga incidentet e shumta të kryera kundër serbëve të Kosovës, duke përfshirë rrëmbimet dhe vrasjet. Si rezultat, UNMIK-u pranoi qindra raporte lidhur me rrëmbimet dhe vrasjet me të cilat i kërkohej të merret.
59. Megjithatë, ekzistenca e “rrethanave të veçanta” që ndikuan në aftësinë e UNMIK-ut për të hetuar krimet “në veçanti në fazën fillestare të misionit të tij kur fokusi kryesor ishte drejtuar në ndërtimin e kapaciteteve të veta lokale policore” duhet gjithashtu të merret parasysh. Në mes tjerash, PSSP-ja deklaron se UNMIK-u nuk e kishte kontrollin e vetëm mbi rekrutimin apo përzgjedhjen e policëve ndërkombëtarë të vendosur nga shtetet anëtare të OKB-së dhe se, shpesh, këta policë kishin përvojë të pamjaftueshme të hetojnë efektivisht krimet ndër-etnike në një kontekst pas konflikti. Problem tjetër ishte rotacioni i rregullt i policëve i cili shpesh çoi te humbja e vazhdimësisë së hetimit. PSSP-ja deklaron se, për shkak të kufizimeve strukturore të “mekanizmit operacional të OKB-së” i cili, duke mos pasur forcë të veten të përhershme policore, duhej mbështetur në kontributet e shteteve anëtare, hetimet e Policisë së UNMIK-ut nuk mund të krahasohen me hetimet e kryera nga një polici normale në shtetet anëtare. PSSP-ja argumenton se standardet e vendosura në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut “nuk mund të jenë të njëjta për UNMIK-un si për një shtet me aparat policor funksional dhe të organizuar mirë në vend dhe policë që mund t’i përzgjedh, rekrutojë dhe trajnojë kujdesshëm”.
60. Për sa i përket hetimit të UNMIK-ut për rastin e z. R.P. dhe z. M.P., PSSP-ja thotë në fillim se nuk është e qartë nga dokumentet hetimore se kur saktësisht i ishte raportuar UNMIK-ut zhdukja e tyre; megjithatë është “e sigurt” se më 16 prill 2004 ZPZHML e UNMIK-ut kishte pranuar një deklaratë dëshmitareje nga dëshmitarja, e cila ishte marrë nga Zyra e UNMIK-ut në Beograd. Më 1 qershor 2005, trupat e z. R.P. dhe z. M.P ishin gjetur dhe ishin kryer autopsitë pas kësaj.

61. PSSP-ja deklaroi se, në korrik të vitit 2005, sapo e identifikoi dhe gjeti z. N., “shqiptarin” e përmendur në deklaratën e dëshmitares, Policia e UNMIK-ut e intervistoi atë. Në këtë drejtim, PSSP-ja pranon se kishte një “vonesë të pashpjegueshme prej një viti” ndërmjet deklaratës së ankueses dhe kohës që UNMIK-u mori deklaratën e z. N. Ai gjithashtu deklaroi se deklarata “nuk ishte nënshkruar nga dëshmitarja por nga një hetues i UNMIK-ut” dhe se në këtë deklaratë, z. N. “konfirmoi në esencë” rrëfimin e ngjarjeve nga ankuesja me disa “shtesa dhe mospërputhje”.
62. PSSP-ja gjithashtu deklaroi se më 10 gusht 2005, NJKL e UNMIK-ut finalizoi hetimin ante-mortem për rastin e z. R.P. dhe z. M.P. dhe, më 16 gusht 2005, regjistroi rastin në sistemin e vet si “joaktiv”. Në ndërkohë, në mes nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2005, trupat e gjetur në qershor të vitit 2005 ishin identifikuar si të z. R.P. dhe z. M.P. dhe iu dorëzuan familjes së tyre.
63. Në tetor të vitit 2007, një hetues i NJKL-së së UNMIK-ut e rishqyrtoi rastin duke vënë në dukje se dosja për rastin nuk përmbante deklaratën e z. N. dhe deklaroi se dosja nuk mund të “mbyllej pa këtë pjesë të dëshmisë”. Është mendim i PSSP-së se hetuesi shqyrtues “nuk e kishte në dispozicion raportin e hetimit ante-mortem të 10 gushtit të vitit 2005 dhe nuk kishte dijeni për faktin se [N.] ishte intervistuar” nga NJKL-ja.
64. PSSP-ja deklaroi se, pasi rasti ishte rishqyrtuar nga NJHKL e EULEX-it në korrik të vitit 2009, prokurori përgjegjës vendosi ta vazhdojë hetimin, megjithëse baza nuk është qartësuar. ZPSK e EULEX-it nuk e përfshiu rastin në “listën e rasteve me prioritet” prandaj asnjë veprim aktiv hetimor nuk ishte ndërmarrë.
65. PSSP-ja argumenton se, duke marrë parasysh numrin e madh të rrëmbimeve dhe zhdukjeve që UNMIK-u duhej t'i hetonte dhe “mangësitë e pandara të një force policore me mision fushor”, veprimet hetimore të kryera nga UNMIK-u në këtë rast duken “të duhura dhe të mjaftueshme”. PSSP-ja pranon se ka pasur disa dështime në hetim, sikur vonesa njëvjeçare para se të merrej në vitin 2005 deklarata e z. N., vetëm pasi trupat e z. R.P. dhe z. M.P. ishin gjetur. Ai gjithashtu pranon se kjo deklaratë “lë disa çështje të pasqaruara, për shembull pse [z.N.] nuk i mori [z. R.P. dhe z. M.P.] me vete në Prishtinë herën e dytë kur ata u takuan”. Megjithatë, sipas mendimit të tij “nuk ka indikacione se [z. N.] kishte qenë i përfshirë në rrëmbimin penal apo vrasjen e [z. R.P. dhe z. M.P.]”. Pasi hetuesit nuk kishin pista tjera të hetimit se kush mund të ishin autorët, vendimi që hetimi duhet të mbetet “i hapur por joaktiv”, “nuk duket i paarsyeshëm” në ato rrethana. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, PSSP-ja argumenton se hetimi duhet të konsiderohet efektiv.

3. Vlerësimi i Panelit

Dorëzimi i dosjeve relevante

66. PSSP-ja vëren se të gjitha dosjet në dispozicion lidhur me hetimin i janë paraqitur Panelit.
67. Paneli thekson se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, thuhet që Paneli mund të kërkojë dorëzimin nga UNMIK-u të çdo dokumenti dhe që PSSP-ja të bashkëpunojë me Panelin dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti, lëshimin e dokumenteve dhe informatave relevante për ankesën. Paneli në lidhje me këtë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që duhet

nxjerrë konkluzion nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurave, duke përfshirë dështimin e vet “për t’i dorëzuar informatat në duart e tyre pa një sqarim të kënaqshëm” (shih GJEDNJ, *Çelikkbilek kundër Turqisë*, nr. 27693/95, vendimi i gjykatës, 31 maj 2005, § 56).

68. Paneli gjithashtu thekson që ruajtja e duhur e dosjeve hetimore lidhur me krimet siç janë vrasjet dhe zhdukjet, nga hapja e hetimit deri te dorëzimi i tyre, është vendimtare për vazhdimin e hetimeve të tilla dhe dështimi për ta bërë këtë mund t’i ngritë çështjet *vetvetiu* sipas nenit 2.
69. Paneli nuk është në pozitë të verifikojë plotësinë e dosjeve të pranura të hetimit. Prandaj, Paneli do të vlerësojë bazueshmërinë e ankesës në bazë të dokumenteve që janë në dispozicion (në këtë kuptim shih GJEDNJ, *Tsechoyev kundër Rusisë*, nr. 39358/05, vendimi i gjykatës, 15 mars 2011, § 146).

a) *Parimet e përgjithshme në lidhje me obligimin për të kryer hetim efektiv sipas nenit 2*

70. Paneli thekson që obligimi pozitiv për t’i hetuar zhdukjet pranohet gjerësisht në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, së paku që nga rasti i Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut *Velásquez-Rodríguez* (shih Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (GJNADNJ), *Velásquez-Rodríguez kundër Hondurasit*, vendimi i gjykatës, 29 korrik 1988, seria C nr. 4). Obligimi pozitiv gjithashtu është kërkuar nga KDNJ siç rrjedh nga neni 6 (e drejta në jetë), neni 7 (ndalimi i trajtimit mizor dhe jonjerëzor) dhe neni 9 (e drejta në liri dhe siguri të personit), shpallur në lidhje me nenet 2 (3) (e drejta për kompensim efektiv) e KNDCP (shih KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 6, 30 prill 1982, § 4; KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 31, 26 maj 2004, §§ 8 dhe 18, KDCP/C/21/Rev.1/Shtojca 13; shih gjithashtu mes tjerash, KDNJ, *Mohamed El Awani kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, komunikata nr. 1295/2004, mendimet e 11 korrikut 2007, KDCP/C/90/D/1295/2004). Obligimi për të hetuar zhdukjet dhe vrasjet gjithashtu kërkohet në Deklaratën e OKB-së mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet e Imponuara (A/Rez/47/133, 18 dhjetor 1992), dhe më tutje e detajuar në udhëzimet e OKB-së, siç janë Manuali i OKB-së mbi Parandalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve Jashtëligjore Arbitrare dhe Përmbledhëse (1991) dhe “Udhëzime për Kryerjen e Hetimeve të Kombeve të Bashkuara për Akuzat për Masakra” (1995). Rëndësia e obligimit konfirmohet me miratimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet e Imponuara në vitin 2006, e cila hyri në fuqi më 23 dhjetor 2010.
71. Me qëllim të trajtimit të akuzave të ankueses, Paneli i referohet, në veçanti, praktikës gjyqësore të vërtetuar mirë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi obligimet procedurale sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata ka gjetur që “[o]bligimi për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas nenit 2, shpallur në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t’i “siguruar secilit brenda juridiksionit [të vet] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [K]onventë”, kërkon shprehimisht që duhet të ketë disa forma të hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë ...” (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës, 27 shtator 1995, § 161, seria A nr. 324; dhe GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 19 shkurt 1998, § 105, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1998-I; shih gjithashtu GJEDNJ, *Jasinskis kundër Letonisë*, nr. 45744/08, vendimi i gjykatës, 21 dhjetor 2010, § 71). Detyra për të kryer një hetim të tillë del në të gjitha rastet e vrasjes dhe vdekjeve tjera të dyshimta, pavarësisht nëse

autorët ishin personat privatë apo agjentët e shtetit apo janë të panjohur (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, vendimi i gjykatës, 5 nëntor 2009, § 191).

72. Gjykata Evropiane po ashtu ka shpallur që obligimi procedural për të siguruar disa forma të hetimit zyrtar efektiv ekziston, gjithashtu, kur një individ është zhdukur në rrethana kërcënimi me jetë dhe nuk kufizohet në rastet ku është e qartë që zhdukja u shkaktua nga një agjent i shtetit (shih GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 55 më lart në § 136).
73. Autoritetet duhet të veprojnë vetë, sapo çështja të ketë arritur në vëmendjen e tyre, dhe ato nuk mund t'ia lënë atë iniciativës të të afërmit për të paraqitur ankesë formale apo të marrë përgjegjësinë për kryerjen e ndonjë procedure hetimore (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, vendimi i gjykatës, 6 prill 2004, § 310, shih gjithashtu GJEDNJ, *Isayeva kundër Rosisë*, nr. 57950/00, vendimi i gjykatës i 24 shkurtit 2005, § 210).
74. Duke vendosur standardet për një hetim efektiv, gjykata ka shpallur që “përveç të qenit i pavarur, i qasshëm për familjen e viktimës me gatishmërinë dhe saktësinë, dhënies së elementit të mjaftueshëm për shqyrtim publik të hetimit dhe rezultateve të tij, hetimi duhet gjithashtu të jetë efektiv në kuptimin që të jetë në gjendje të shpie në përcaktimin nëse vdekja është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe nëse po, kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 55 më lart, në § 191; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, nr. 4704/04, vendimi i gjykatës, 15 shkurt 2011, § 63). Ky nuk është vetëm një obligim për arritjen e rezultateve, por edhe për përdorimin mjeteve të duhura. Autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapash të arsyeshëm për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë ndër të tjera dëshmitë e dëshmitarit okular, dëshmitë e mjekësisë ligjore dhe, ku është e nevojshme, një autopsi e cila siguron të dhëna të plota dhe të sakta për lëndimin dhe një analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo e metë në hetim e cila rrezikon aftësinë për të vërtetuar shkaktarin e vdekjes ose personin apo personat përgjegjës, do të rrezikojë të jetë si parregullsi sa i përket këtij standardi (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur më lart, në § 312; dhe *Isayeva kundër Rosisë*, përmendur më lart, në § 212).
75. Në veçanti, përfundimi i hetimit duhet të bazohet në analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante. Mosndjekja e një piste të qartë të hetimit rrezikon deri në shkallë vendimtare aftësinë për t'i vërtetuar rrethanat e rastit dhe identitetin e atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, përmendur në § 71 më lart, në § 201). Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit, të cilat plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit, varen nga rrethanat e rastit të veçantë. Ato duhen vlerësuar në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih GJEDNJ, *Velcea dhe Mazëre kundër Rumanisë*, nr. 64301/01, vendimi i gjykatës, 1 dhjetor 2009, § 105).
76. Në mënyrë specifike për sa u përket personave të zhdukur që më vonë janë gjetur të vdekur, e cila situatë nuk është në rastin aktual, gjykata ka shpallur që procedurat e zhvarrimit dhe identifikimit të mbetjeve mortore nuk shterojnë obligimin sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata konsideron që “obligimi procedural që del nga zhdukja do të mbetet përgjithësisht

për sa kohë që vendndodhja dhe fati i personit janë të panjohura dhe kështu është i një natyre të vazhdueshme” (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 74 më lart në § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 53 më lart në § 148, *Aslakhanova dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 2944/06 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 18 dhjetor 2012, § 122). Megjithatë, gjykata gjithashtu thekson që ky obligim procedural “nuk përfundon madje edhe me zbulimin e trupit Kjo vetëm hedh dritë në një aspekt të fatit të personit të zhdukur dhe obligimi për të shpjeguar zhdukjen dhe vdekjen, dhe gjithashtu për të identifikuar dhe ndjekur çdo autor të akteve të paligjshme në lidhje me këtë përgjithësisht mbetet” (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur më lart, në § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 55 më lart në § 145). Megjithëse gjetja dhe identifikimi pasues i mbetjeve mortore të viktimës mundën vetvetiu të jenë arritje të rëndësishme, obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të ekzistojë (shih GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur më lart, në § 64).

77. Sa i përket kërkesës për shqyrtim publik, gjykata ka shpallur më tutje që duhet të ketë elemente të mjaftueshme të shqyrtimit publik të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar përgjegjësi në praktikë dhe në teori. Shkalla e shqyrtimit të kërkuar publik mundet të ndryshojë mjaft nga rasti në rast. Në të gjitha rastet, megjithatë, i afërmi i viktimës duhet të jetë i përfshirë në procedurë deri në shkallën që mbron interesat e tij legjitime (shih GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të tjerët*, përmendur në § 73 më lart, në §§ 311-314; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 73 më lart, në §§ 211-214 dhe rastet e përmendura aty; GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës nr. 55721/07, 7 korrik 2011, § 167, KEDNJ 2011).
78. GJykata gjithashtu ka theksuar rëndësinë e madhe të hetimit efektiv për gjetjen e së vërtetës se çfarë ka ndodhur, jo vetëm për familjet e viktimave por gjithashtu edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme, dhe gjithashtu publikun e gjerë, të cilët kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur (GJEDNJ [DHL], *El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 39630/09, vendimi i gjykatës, 13 dhjetor 2012, § 191). Organizata e Kombeve të Bashkuara gjithashtu pranon rëndësinë e së drejtës për të ditur të vërtetën. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, “e drejta për ta ditur të vërtetën nënkupton njohurinë e tërë dhe të plotë rreth shkeljeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur, rrethanat e tyre specifike dhe kush mori pjesë në to. Në rastin e personave të zhdukur ... ajo gjithashtu nënkupton të drejtën për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e viktimës” (shih Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Personat e zhdukur, Dokument i OKB-së A/67/267, 8 gusht 2012, § 5; shih gjithashtu Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB-së, Rezolutat 9/11 dhe 12/12: E drejta për të ditur të vërtetën, 24 shtator 2008 dhe 12 tetor 2009; shih gjithashtu Raportin e raportuesit special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale ndërsa luftohet terrorizmi, Ben Emmerson, Parimet kryesore për sigurimin e përgjegjësisë së zyrtarëve publikë për shkeljet e rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut në kontekst të iniciativave të shtetit kundër terrorizmit; Dokument i OKB-së A/KDNJ/22/52, 1 mars 2013).

b) *Aplikueshmëria e nenit 2 në kontekstin e Kosovës*

79. Paneli është i vetëdijshëm për faktin se rrëmbimi dhe vrasja e z. R.P. dhe z. M.P. ndodhi pak pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, menjëherë pas konfliktit të armatosur kur krimi, dhuna dhe pasiguria ishin shumë të përhapura.

80. Për pjesën e tij, PSSP-ja nuk e konteston që UNMIK-u e kishte për detyrë ta hetonte rastin aktual sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Megjithatë, sipas PSSP-së, rrethanat unike të ndërlidhura me kontekstin e Kosovës dhe vendosjen e UNMIK-ut në fazën e parë të misionit, duhet marrë parasysh kur vlerësohet nëse ky hetim është në pajtim me nenin 2 të KEDNJ-së. Në esencë, PSSP-ja argumenton që nuk është e mundshme të vlejë për UNMIK-un të njëjtat standarde të aplikueshme për një vend në një situatë normale.
81. Paneli konsideron që argumentet e PSSP-së ngrisin dy pyetje kryesore: e para, nëse standardet e nenit 2 vazhdojnë të vlejë në situatën e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar dhe, e dyta, nëse standardet e tilla duhet konsideruar plotësisht të aplikueshme për UNMIK-un.
82. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 për UNMIK-un, Paneli rikujton që me miratimin e Rregullores së UNMIKU-t nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në ushtrimin e funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, përmes së cilës UNMIK-u mori përsipër obligimet sipas instrumenteve të caktuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë KEDNJ-në. Në lidhje me këtë, Paneli tanimë ka gjetur se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh në lidhje me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 dhe të tjerët, mendimi i 24 marsit 2011, § 44; *Berisha dhe të tjerët*, nr. 27/08 dhe të tjerët, mendimi i 23 shkurtit 2011, § 25; *Laliq dhe të tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerët, mendimi i 9 qershorit 2012, § 22).
83. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 në situatat e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar, Paneli rikujton që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur aplikueshmërinë e nenit 2 në situatat pas konfliktit, duke përfshirë vendet e ish-Jugosllavisë (shih mes shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 74 më lart dhe GJEDNJ, *Julariq kundër Kroacisë*, nr. 20106/06, vendimi i gjykatës, 20 janar 2011). Gjykata ka konsideruar më tutje që obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të zbatohet në “kushte të rënda të sigurisë, duke përfshirë një kontekst të konfliktit të armatosur” (shih GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 77 më lart, në § 164; shih gjithashtu GJEDNJ, *Güleq kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 27 korrik 1998, § 81, Raportet 1998-IV; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 28 korrik 1998, §§ 79 dhe 82, Raportet 1998-IV; GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 73 më lart, në §§ 85-90, 309-320 dhe 326-330; *Isayeva kundër Ruisë*, përmendur në § 73 më lart, në §§ 180 dhe 210; GJEDNJ, *Kanlibaş kundër Turqisë*, nr. 32444/96, vendimi i gjykatës, 8 dhjetor 2005, §§ 39-51).
84. Gjykata ka pranuar që “ku vdekja [dhe zhdukjet] që duhet hetuar sipas nenit 2 ndodhin në rrethana të dhunës së përgjithësuar, konfliktit të armatosur apo kryengritjes, pengesat mund të vendosen në rrugën e hetuesve dhe shtrëngesat konkrete mund të detyrojnë përdorimin e masave më pak efektive të hetimit apo mund të bëjnë që ndonjë hetim të shtyhet” (shih, GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur më lart në § 164; GJEDNJ, *Bazorkina kundër Ruisë*, nr. 69481/01, vendimi i gjykatës, 27 korrik

- 2006, § 121). Megjithatë, gjykata konsideron që “obligimi sipas nenit 2 për të mbrojtur jetën detyron që, madje edhe në kushte të rënda sigurie, të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të ndërmerren për të siguruar se po kryhet një hetim efektiv dhe i pavarur për shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë (shih mes shumë shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, përmendur në §71 më lart në §§ 86-92; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, përmendur më lart në §§ 82-85; GJEDNJ [DHL], *Tanrikulu kundër Turqisë*, nr. 23763/94, vendimi i gjykatës, 8 korrik 1999, §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; GJEDNJ, *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rosisë*, nr. 57942/00 dhe 57945/00, vendimi i gjykatës, 24 shkurt 2005, §§ 156-166; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rosisë*, përmendur në § 78 më lart, në §§ 215-224; GJEDNJ, *Musayev dhe të tjerët kundër Rosisë*, nr. 57941/00 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 26 korrik 2007, §§ 158-165).
85. Ngjashëm, KDNJ konsideron që e drejta për jetë, duke përfshirë garancitë e veta procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet kurrfarë shmangie, madje edhe në kohën e emergjencave publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit (shih, KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 6, përmendur në § 70 më lart, në § 1; KDNJ, *AbubakarAmirov dhe AïzanAmirova kundër Federatës Ruse*, komunikata nr. 1447/2006, mendimet e 22 prillit 2009, § 11.2, KDCP/C/95/D/1447/2006). Për më tepër, KDNJ ka shpallur aplikueshmërinë e nenit 2 (3), 6 dhe 7 të KNDCP me referencë specifike në obligimin e UNMIK-ut për të kryer hetime të duhura për zhdukjet dhe rrëmbimet në Kosovë (shih KDNJ, *Observime përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Njeriut: Kosovë (Serbi)*, 14 gusht 2006, §§ 12-13, KDCP/C/UNK/CO/1).
86. Paneli vlerëson vështirësitë në të cilat UNMIK-u hasi gjatë fazës së parë të vendosjes së tij. Paneli thekson që rëndësia e duhur kushtuar çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, nënkupton që UNMIK-u është dashur t'i marrë parasysh të dyja dimensionet humanitare dhe penale të situatës. Në veçanti, Paneli konsideron se rëndësia që u është kushtuar hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë që kufizuan aftësinë e autoriteteve hetimore për t'i kryer hetimet e tilla, siç u përshkrua nga PSSP-ja, ishin vendimtare që UNMIK-u të krijojë nga fillimi një ambient të favorshëm për kryerjen e hetimeve kuptimplota. Kjo do të përfshinte krijimin e një sistemi ku do të hynin elementet e tilla, siç janë dhënia e përgjegjësisë së plotë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e progresit në hetime, sigurimin e shqyrtimit të rregullt të gjendjes së hetimeve dhe një proces për dorëzim të duhur të rasteve ndërmjet nëpunësve apo njërive të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut. Një sistem i tillë gjithashtu duhet marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve (shih, *mutatismutandis*, GJEDNJ, *R.R. dhe të tjerët kundër Hungarisë*, nr. 19400/11, vendimi i gjykatës, 4 dhjetor 2012, §§ 28-32), dhe gjithashtu të konsiderojë cënueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit (shih GJEDNJ [DHL], *Sargsyan kundër Azerbajxhanit*, nr. 40167/06, vendimi i 14 dhjetorit 2011, § 145; dhe GJEDNJ [DHL], *Chiragov dhe të tjerët kundër Armenisë*, nr. 13216/05, vendimi i 14 dhjetorit 2011, § 146). Ndonëse kuptohet që vendosja dhe organizimi i organeve të policisë dhe drejtësisë ndodhi gradualisht, Paneli mendon që ky proces përfundoi në vitin 2003, kur sistemi i policisë dhe gjyqësisë në Kosovë nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së u përshkrua se “funksionon mirë” dhe është “i qëndrueshëm” (shih § 20 më lart).
87. Paneli më tutje tërheq vëmendjen që detyra e tij nuk është t'i shqyrtojë praktikatat relevante apo pengesat e pretenduara për të kryer hetime efektive *in abstracto*, por vetëm në lidhje me aplikimin e tyre specifik në rrethana të veçanta të një situatë që është çështje para tij (shih GJEDNJ, *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës, 29

nëntor 1988, § 53, seria A nr. 145-B). Kështu, Paneli pajtohet me PSSP-në, që natyra dhe shkalla e shqyrtimit për të përcaktuar nëse efektiviteti i hetimit e plotëson prapun minimal varet nga rrethanat e rastit të caktuar. Për këto arsye, Paneli konsideron që do të vërtetojë në lidhje me secilin rast nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të kryer një hetim efektiv siç përshkruhet nga neni 2, duke pasur parasysh realitetet e punës hetimore në Kosovë.

c) *Pajtueshmëria me nenin 2 në rastin aktual*

88. Duke iu kthyer rrethanave të këtij rasti, Paneli thekson që kishte mangësi në kryerjen e hetimit nga zanafilla e tij, duke pasur parasysh që faza fillestare e hetimit është e një rëndësie shumë të madhe. Megjithatë, në dritë të vlerësimeve të bëra më lart lidhur me juridiksionin e tij të limituar dhe të përkohshëm (shih § 55), Paneli sjell ndërmend që është kompetent *ratione temporis* për të vlerësuar pajtueshmërinë e hetimit me nenin 2 të KEDNJ-së vetëm për periudhën prej 23 prillit 2005, duke pasur parasysh gjendjen e rastit në atë datë (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 74 më lart në § 70). Periudha në shqyrtim përfundon më 9 dhjetor 2008, me marrjen e përgjegjësisë nga EULEX-i në fushën e administrimit të drejtësisë (shih § 20-21 më lart).
89. Paneli pajtohet me PSSP-në se nuk është e mundshme të përcaktohet nga dokumentacioni në dosjen hetimore se kur zhdukja e z. R.P. dhe z. M.P. iu raportua UNMIK-ut. Megjithatë, Paneli thekson se në fillim të prillit të vitit 2000, Njësi i Inteligjencë i Policisë së UNMIK-ut kishte pranuar informata se z. R.P. gjoja ishte mbajtur ilegalisht nga UÇK-ja në Skënderaj. Paneli gjithashtu thekson se emrat e z. R.P. dhe z. M.P. ishin përfshirë në listën e personave të zhdukur që KNKK ia përcolli UNMIK-ut më 21 tetor 2001 dhe, prandaj, konsideron se, së paku deri me këtë datë, UNMIK u vu në dijeni për zhdukjen e tyre.
90. Paneli gjithashtu thekson se, siç duket nga numrat e dosjes që janë dhënë për rastin nga NJPZH, një dosje për person të zhdukur lidhur me z. R.P. dhe z. M.P. ishte hapur menjëherë, nga NJPZH, në një kohë në vitin 2001. Kjo dosje referohet në gjithë dosjen hetimore alternativisht si lënda nr. 2001-011304 apo lënda nr. 2001-001034 kështu që nuk është e mundshme të konstatohet se cili është numri i saktë i regjistrimit të rastit (pasi të dy numrat për rastin shfaqen në krejt dosjen që i referohet rastit, nuk është e mundshme të konstatohet nëse kjo është bërë gabimisht).
91. Përveç kësaj, Paneli thekson se, siç shihet nga shqyrtimi nga EULEX-i për rastin në vitin 2009, së paku dy dosje për rastin ishin hapur lidhur me hetimin penal për zhdukjen e z. R.P. dhe z. M.P., njëra në vitin 2002 dhe njëra në vitin 2005 nga NJKL (ish-dosja e Policisë së UNMIK-ut nr. 2002-00067, gjetur të jetë nga prokurori i EULEX-it “saktësisht e njëjta si 2005-00107”, shih § 45 më lart).
92. Në fillim, Paneli thekson se është e qartë nga dosja hetimore se në prill të vitit 2000 Policia e UNMIK-ut kishte pranuar një raport të inteligjencës sipas të cilit djali i ankuseses, z. R.P., ishte mbajtur ilegalisht nga UÇK-ja në qendrën e paraburgimit në Skënderaj (shih §§ 27-28 më lart). Raporti i njëjtë përmbante informatën se personat tjerë të treguar me emër ishin “mbajtur kundër dëshirës së tyre” në 111 “kampe përqendrimi” të UÇK-së dhe ofruan indikacion të lokacionit të tyre dhe, në disa raste, të pjesëtarëve përgjegjës të UÇK-së. Paneli thekson me shqetësim se nuk ka asnjë dokumentacion në dosje që tregon se Policia e

UNMIK-ut mori ndonjë veprim për të verifikuar apo hetuar më tutje këtë informatë, jo vetëm sa i përket rastit të z. R.P. por gjithashtu sa i përket një hetimi më të gjerë që përfshin një model të mundshëm të rrëmbimeve dhe paraburgimeve ilegale të UÇK-së në gjithë Kosovën dhe Shqipërinë veriore.

93. Paneli gjithashtu thekson se, pasi që zhdukja e të dyve z. R.P. dhe z. M.P. i ishte raportuar KNKK-së në vitin 2001, dhe për rreth tre vjet pas kësaj, nuk ishte ndërmarrë çfarëdo qoftë veprimi në këtë rast, nga NJPZH apo NJKL, derisa Zyra për Persona të Zhdukur e UNMIK-ut në Beograd mori një deklaratë nga ankuesja në prill të vitit 2004. Paneli gjithashtu thekson se deklarata e dëshmitares ofroi informata se z. R.P. dhe z. M.P. kishte shumë të ngjarë të kenë qenë viktima të një krimi dhe gjithashtu ofruan pista të shumta hetimi (emra të dëshmitarëve dhe të të dyshuarve të mundshëm, një përshkrim të detajuar dhe targat e regjistrimit të kamionit që ishte zhdukur me ata) për veprim të mëtejshëm hetimor. Nuk ka asnjë indikacion në dosje të veprimeve të ndërmarra përcjellëse hetimore pas marrjes së kësaj deklarate.
94. Duke ardhur te periudha nën juridiksion e vet, Paneli thekson se më 1 qershor 2005 NJPZH e UNMIK-ut gjeti mbetjet mortore në Klinë, më vonë të identifikuara si të z. R.P. dhe z. M.P.
95. Në fund të qershorit të vitit 2005, siç është pranuar nga PSSP-ja, me një “vonesë të pasqaruar prej një viti” pasi ishte marrë deklarata e ankueses nga NJPZH, NJKL përfundoi një hetim ante-mortem mbi zhdukjen e z. R.P. dhe z. M.P. Në këtë proces, NJKL ia arriti, përmes disa hetimeve, të identifikojë, gjejë dhe intervistojë z. N.B. (z. N. në rrëfimin e ankueses), dëshmitarja kryesore potenciale në rast. Paneli së pari thekson se kjo deklaratë, siç është pranuar gjithashtu nga PSSP-ja, ishte regjistruar shumë keq: ishte përfshirë në tekstin kryesor të raportit të policisë dhe nuk ishte nënshkruar nga dëshmitarja. Përveç kësaj, nuk ishte bërë asnjë pyetje nga hetuesit sa i përket datave të ngjarjes në fjalë. Për më tepër, Paneli gjithashtu thekson se disa mospërputhshmëri dolën ndërmjet dëshmitave të ofruara nga ankuesja dhe nga z. N.B. (për shembull nëse vëllai i z. N.B. ishte lënduar në kokë apo sup; në rrëfimin e ankueses, z. N.B. nuk e kishte takuar djalin dhe burrin e saj pas udhëtimit të parë në spital). Paneli gjithashtu thekson “disa çështje të pasqaruara” (për shembull ajo e identifikuar nga PSSP-ja se “pse [z. N.B.] nuk i mori ata me vete në Prishtinë herën e dytë që u takuan”, dhe gjithashtu faktin se z. N.B. kishte deklaruar se ai po e përcillte kamionin me automjetin e tij por gjoja se ai nuk e pa vëllanë e tij duke kërcyer nga kamioni). Megjithatë, nuk ka asnjë indikacion në dosje se NJKL bëri ndonjë përpjekje të qartësojë këto mospërputhshmëri përmes, për shembull, marrjes së një deklarate tjetër nga ankuesja dhe përmes rimarrjes në pyetje së të dy dëshmitarëve. Përveç kësaj, nuk ka asnjë indikacion se ndonjë veprim tjetër, përveç intervistimit të z. N.B. ishte ndërmarrë nga NJKL-ja, duke përfshirë hapat themelore hetimorë, siç janë gjetja dhe intervistimi i pronarit të kompanisë transportuese, gjetja dhe intervistimi i vëllait të z. N.B., i raportuar gjithashtu si një dëshmitar okular i rastit, fillimi i një kërkimi për kamionin, apo “kontrollimi” i zonës në vendin e supozuar të krimit.
96. Mungesa e qartë e një reagimi të menjëhershëm të Policisë së UNMIK-ut mund t’u ketë dërguar sinjalin autorëve që, autoritetet ose nuk ishin në gjendje apo nuk ishin të gatshme t’i hetojnë aktet e tilla kriminale. Një qëndrim i tillë i autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në ndonjë shoqëri, dhe veçanërisht në rrethanat pas konfliktit, krijon pashmangshëm një kulturë të mosdëshkimit ndër kriminelët dhe mund të çojë vetëm në përkeqësim të situatës.

Problemet të cilat UNMIK-u i hasi në fillim të misionit të vet, të cilat u çekën më lart, nuk arsyetojnë mosveprimin e tillë, as në fillim e as më vonë.

97. Nuk është ofruar asnjë sqarim nga PSSP për atë se pse dosja hetimore përmban dokumentet e mjekësisë ligjore (raportin e autopsisë, certifikatën e vdekjes dhe identifikimit) vetëm për z. M.P. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara Panelit nga ankuesja në lidhje me këtë (shih § 24 më lart) Paneli pranon se, në periudhën prej disa muajsh, nga qershori i vitit 2005 deri në nëntor të vitit 2005, autopsitë ishin kryer të cilat, së paku për z. M.P., përcaktuan shkaktarin e vdekjes dhe ishin bërë aranzhime për identifikim, duke përfshirë analizën përmes ADN-së. Pas identifikimit, mbetjet mortore të z. R.P. dhe z. M.P. iu dorëzuan familjes së tyre në dhjetor të vitit 2005.
98. Paneli rikujton se, megjithëse gjetja dhe identifikimi i mbetjeve mortore të z. R.P. dhe z. M.P. mund të konsiderohet vetvetiu një arritje, obligimi procedural sipas nenit 2 nuk ka përfunduar me gjetjen e mbetjeve mortore, veçanërisht pasi ato treguan (veçanërisht në rastin e z. M.P.) dëshmi të vdekjes së dhunshme. Paneli gjithashtu thekson se, derisa ata që janë përgjegjës për krimin nuk janë gjetur, UNMIK-u ishte i obliguar të shqyrtojë rregullisht progresin e hetimit, për të siguruar që asgjë nuk neglizhohet dhe që ndonjë dëshmi e re është marrë parasysh, dhe gjithashtu t'i informojë të afërmit e tyre lidhur me pistat e mundshme dhe të reja të hetimit.
99. Paneli thekson se rasti ishte rishqyrtuar në korrik të vitit 2007 dhe, përsëri, në tetor të vitit 2007 nga NJHKL-ja. Të dy shqyrtimet, megjithatë, ishin larg nga të qenit adekuate. Sipas të dy shqyrtimeve, z. R.P. dhe z. M.P. ishin duke transportuar mallra nga Peja; kamioni i tyre ishte prishur dhe z. N. (vetëm emri i parë është ofruar, pasi Policia akoma nuk e kishte identifikuar atë) kishte shkuar në Prishtinë për të gjetur një mekanik për vetura. Gjatë kthimit, z. N. kishte gjetur z. R.P. dhe z. M.P. Gjithashtu, sipas hetuesit shqyrtues, vetëm trupi i z. M.P. ishte gjetur dhe dorëzuar familjes. Gjatë shqyrtimit të dytë në tetor të vitit 2007, hetuesi përgjegjës zbuloi se dosjes i mungonte një deklaratë nga dëshmitari kryesor, z. N.B. dhe se nuk mund të mbyllej pa “këtë pjesë të dëshmisë”; prandaj u rekomandua që hetimi i mëtejshëm të ndërmerret nga policia lokale dhe ndërkombëtare. Paneli thekson me shqetësim argumentin e PSSP-së se hetuesi shqyrtues nuk kishte në dispozicion të tij raportin e hetimit ante-mortem të vitit 2005 dhe, për këtë arsye, nuk ishte i vetëdijshëm se një deklaratë ishte marrë nga z. N.B. më parë në vitin 2005. Kjo deklaratë e PSSP-së ngrit pyetjet rreth asaj se pse hetuesi nuk e kishte këtë dokument të rëndësishëm në dispozicion të tij dhe rreth asaj se si një shqyrtim i rastit mund të bëhet pa e pasur një nga raportet më të rëndësishme të përpiluara deri tani nga Policia e UNMIK-ut.
100. Në këtë drejtim, Paneli tanimë ka theksuar parimin që ruajtja e duhur e dosjeve hetimore lidhur me krimet siç janë vrasjet dhe zhdukjet, nga hapja e hetimit deri te dorëzimi i tyre, është vendimtare për vazhdimin e hetimeve të tilla dhe dështimi për ta bërë këtë mund t'i ngritë çështjet *vetvetiu* sipas nenit 2. Paneli gjithashtu thekson se është evidente në rastin aktual se ruajtja e dobët e dosjes hetimore, së bashku me shqyrtimin joadekuat të rastit e rrezikuan seriozisht efektivitetin e hetimit dhe vazhdimin e tij, duke përfshirë atë të kryer nga EULEX-i.
101. Nuk është e qartë gjithashtu për Panelin nëse ky hetim ishte shqyrtuar nga prokurori në ndonjë fazë. Paneli thekson në këtë drejtim se DD i UNMIK-ut e kishte pranuar kallëzimin

penal të ankueses prej shkurtit të vitit 2005 (shih § 34 më lart). Sidoqoftë, në dosje nuk ka asnjë udhëzim zyrtar nga ndonjë prokuror.

102. Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm që detyra për të hetuar nuk duhet ndalur së kryeri vetëm për shkak se hetimi nuk ka sjellë rezultate të kënaqshme. Sidoqoftë, një hetim i tillë duhet të ndërmerret seriozisht dhe jo për një formalitet të thjeshtë.
103. Paneli konsideron se, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit të veçantë, nuk janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm nga UNMIK-u drejt gjetjes së personave të zhdukur, identifikimit të autorëve dhe sjelljes së tyre para drejtësisë. Në këtë kuptim, Paneli konsideron se hetimi nuk ishte adekuat dhe në pajtueshmëri me kërkesat për shpejtësi, ekspeditivitet dhe efektivitet (shih § 74 më lart), siç kërkohet me nenin 2.
104. Në dritë të mungesave dhe mangësive të përshkruara më lart, Paneli konkludon që UNMIK-u dështoi të kryejë një hetim efektiv për zhdukjen dhe vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P. Prandaj, është bërë një shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 3 të KEDNJ-së

105. Paneli konsideron që ankuesja mbështetet, në esencë, në shkeljen e të drejtës për të qenë e lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues, e garantuar sipas nenit 3 të KEDNJ-së.
106. PSSP-ja nuk paraqet parashtrësja tjera me referencë specifike për shkeljen e pretenduar të nenit 3 të KEDNJ-së.
107. Në vendimin e vet të 26 nëntorit të vitit 2010, Paneli i shpalli ankesat të pranueshme. Megjithatë, Paneli duhet të rivlerësojë pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesave, në dritë të zhvillimeve të mëvonshme në praktikën gjyqësore të Panelit lidhur me pranueshmërinë e ankesave sipas nenit 3 të KEDNJ-së.
108. Paneli tanimë ka theksuar se, ku personi i zhdukur është gjetur më vonë i vdekur, aplikueshmëria e nenit 3 të KEDNJ-së është në përgjithësi e kufizuar te periudha e dallueshme gjatë së cilës anëtari i familjes ka pasur pasiguri, vuajtje dhe shqetësim që i përkasin fenomenit specifik të zhdukjeve (shih, *p.sh.*, GJEDNJ, *Luluyev dhe të tjerët kundër Rusisë nr. 69480/01*, vendimi i gjykatës, 9 nëntor 2006, §§ 114-115, *KEDNJ*, 2006-XIII; shih gjithashtu GJEDNJ, *Gongadze kundër Ukrainës*, nr. 34056/02, vendimi i gjykatës, 8 nëntor 2005, § 185, *KEDNJ*, 2005-XI).
109. Në këtë drejtim, pyetja që ngrihet është nëse ankesa ishte dorëzuar me kohë. Në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 thuhet se Paneli “mund të merret me një çështje vetëm ... brenda periudhës prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së vendimit përfundimtar për të”. Si rregull, periudha prej gjashtë muajsh fillon nga data e vendimit final në procesin e shterjes së mjeteve juridike. Ku megjithatë është e qartë nga fillimi se asnjë mjet efektiv juridik nuk është në dispozicion të ankuesit, periudha fillon nga data e akteve apo masave për të cilat është ankimuar, apo nga data e njohurisë për atë akt apo efektin e tij në dëm të ankuesit (GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në §55 më lart, në § 157). Ku ankesa ka të bëjë me një situatë të vazhdueshme, e cila ka ardhur në një përfundim, periudha prej gjashtë muajsh fillon nga data në të cilën situata ka ardhur në një përfundim.

110. Paneli thekson se mbetjet mortore të z. R.P. dhe z. M.P. iu kthyen familjes së ankueses më 8 dhjetor 2005. Është ai momenti që periudha gjatë së cilës mund të ngrihej një çështje sipas nenit 3 të KEDNJ-së, erdhi në një përfundim. Sa i përket nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, kufizimi kohor gjashtëmujor si pasojë filloi të rrjedhë nga ajo datë.
111. Dosja iu dorëzua Panelit më 4 prill 2009, që do të thotë pas skadimit të periudhës gjashtëmujore të përmendur më lart.
112. Paneli nuk ka dyshim për vuajtjen e thellë që i është shkaktuar ankueses nga zhdukja dhe vrasja e djalit dhe burrit të saj. Megjithatë, Paneli duhet të konkludojë se kjo pjesë e ankesës bie jashtë kufizimit kohor të caktuar me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, prandaj, duhet shpallur e papranueshme.

V. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

113. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.
114. Paneli thekson që zhdukjet e imponuara përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, të cilat do të hetohen dhe ndiqen në të gjitha rrethanat. Paneli gjithashtu thekson që UNMIK-u si administrues territorial i Kosovës nga viti 1999 deri më 2008, kishte përgjegjësinë primare që t'i hetojë në mënyrë efektive dhe t'i ndjekë ata që ishin përgjegjës për zhdukjen dhe vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P., dhe se dështimi i tij për ta bërë këtë, paraqet shkelje të mëtejme serioze të të drejtave të viktimave dhe më të afërmve, në veçanti të së drejtës për ta ditur të vërtetën për çështjen.
115. Paneli thekson shqetësimet e PSSP-së që burimet joadekuate, veçanërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e bënë të vështirë arritjen e përbushjes së obligimeve të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut.
116. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart (shih § 20), përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga EULEX-i të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të marrë masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në hetime që ende janë në zhvillim e sipër para EULEX-it apo autoriteteve lokale. Gjithashtu, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ndaloi kryerjen e funksioneve ekzekutive në Kosovë, dhe ky fakt kufizoi aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera, siç kërkohet me parimet e vendosura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
117. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

Për sa i përket ankueses dhe rastit Paneli konsideron se është e nevojshme që UNMIK-u:

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Ruisë*, nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i gjykatës, 2 mars 2010, § 171; GJEDNJ (DHL), *Catan dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Ruisë*, nr. 43370/04, 8252/05 dhe 18454/06, vendimi i gjykatës, 19 tetor 2012, § 109), duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* EULEX-it dhe autoriteteve të Kosovës, të marrë siguri që hetimet në lidhje me rastin në fjalë do të vazhdojnë në pajtueshmëri me kërkesat për një hetim efektiv siç parashihet me nenin 2, që rrethanat që kanë sjellë deri te zhdukja dhe vrasja e z. R.P. dhe z. M.P. do të tregohen dhe që autorët do të sillen para drejtësisë. Ankuesja dhe/apo më të afërmit, do të informohen për veprimet e tilla dhe dokumentet relevante do t'u zbulohen atyre sipas nevojës;
- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të UNMIK-ut që të hetojë në mënyrë adekuate zhdukjen dhe vrasjen e z. R.P. dhe z. M.P. dhe t'u kërkojë falje publike ankueses dhe familjes së saj për këtë;
- Të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesen, për dëmin e shkaktuar moral për shkak të dështimit të UNMIK-ut që të kryejë hetim efektiv.

Paneli gjithashtu e konsideron të nevojshme që UNMIK-u:

- Në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi "Parimet Bazë dhe Udhëzimet mbi të Drejtën për Kompensim dhe Dëmshpërblim për Viktimat për arsye të Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare" (A/Rez/60/147, 21 mars 2006), të ndërmarrë hapa të nevojshëm, përmes organizmave të tjerë të afërt me OKB-në që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe organizatave joqeveritare, për krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmeshjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat nga të gjitha komunitetet që kanë qenë subjekt i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij;
- Të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që të ndajë burime adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar që standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur;

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

- 1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**
- 2. KONSTATON SE ANKESA SIPAS NENIT 3 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT ËSHTË E PAPANUESHME;**
- 3. REKOMANDON QË UNMIK-u:**
 - a. T’U KËRKOJË EULEX-it DHE AUTORITETEVE TË TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË T’I NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM ME QËLLIM TË SIGURIMIT QË HETIMI PENAL PËR ZHDUKJEN DHE VRASJEN E Z. R.P. DHE Z. M.P. DO TË VAZHDOJË NË PAJTIM ME NENIN 2 TË KEDNJ-së DHE QË AUTORËT TË SILLEN PARA DREJTËSISË;**
 - b. TË PRANOJË PUBLIKISHT PËRGJEGJËSINË PËR DËSHTIMIN E VET QË TË KRYEJË HETIM EFEKTIV PËR ZHDUKJEN DHE VRASJEN E Z. R.P. DHE Z. M.P. DHE T’I KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESES;**
 - c. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESES PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË NENIT 2;**
 - d. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR PËR TË KRIJUAR NJË PROGRAM TË PLOTË DHE GJITHËPËRFSHIRËS DËMSHPËRBLIMI;**
 - e. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR NË KOMBET E BASHKUARA SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;**
 - f. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T’I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESEN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

CCIU – Njësiti Qendror për Hetim Penal
CCPR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
DOJ – Departamenti i Drejtësisë
DPPO – Zyra e Qarkut e prokurorit publik
ECHR – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EU – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
FRY – Republika Federale e Jugosllavisë
HRAP – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
IACtHR– Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
ICMP – Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
ICRC – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
ICTY – Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KLA – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MoU - Memorandum i mirëkuptimit
MPU – Njësiti për Persona të Zhdukur
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OMPF – Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore
OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RIU – Njësiti Rajonal për Hetim
SRS – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SPRK- Zyra e Prokurorisë Speciale të EULEX-it
UN – Kombet e Bashkuara
UNHCR – Komisarati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VRIC – Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave
WCIU – Njësiti për Hetim të Krimeve të Luftës